


Bashkia Maliq



Raporti Performancës 2020



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të bashkisë Maliq.

https://public.tableau.com/vieës/Lezh-RaportilInteraktiv2020/Tedhenatadministrative?:language=en&:display_count=y&publish=yes&:origin=viz_share_link

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Maliq me asistencën e Projektit Bashki të Forta dhe Kompania e konsulencës Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Të dhëna të përgjithshme	5
Burimet e Financimit.....	6
Shpenzimet buxhetore.....	7
Investimet.....	8
Treguesit Financiar	9
Administrimi i bashkisë.....	10
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët.....	13
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	15
Rrjeti rrugor rural	17
Furnizimi me ujë.....	20
Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	22

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullësor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.


Treguesit kyç financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave.** Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave. Me pak ndryshime raporti tregon sesa shpenzon bashkia për të ofruar një Lek shërbime publike.
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara


nga viti i kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për bashkinë pasi tregon se ajo nuk mbështetet në burime të jashtëme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.).

- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre.** Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve.** Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave.** Huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një normë e ulët tregon se bashkia është e aftë t'a paguajë borxhin sipas afatit të caktuar. Një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do t'i duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin.
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave.** Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj.). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim		Përkeqësim	
E njëjta situatë		Nuk ka informacion	

Bashkia Maliq



Bashkia Maliq e pozicionuar në jug-lindje të vendit përbëhet nga 7 Njësi Administrative (Moglicë, Gore, Përg, Maliq, Vreshtas, Pojan) me sipërfaqe prej 656.34 km² me sipërfaqe prej 656.34 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Maliqit. Popullsia e bashkisë numëron 41,757 banorë (sipas të dhënave të Censusit) me një përfaqësim gjinor **50.2% femra dhe 49.8% meshkuj**. Bashkia ka një numër total familjesh prej **17,186** nga të cilat 12% në pjesën urbane dhe 88% në pjesën rurale të bashkisë. Rrjeti rrugor prej 563 km linear shtrihet në rreth 11 km në pjesën urbane të saj. Gjatë vitit 2020 u shënuan **828 lindje dhe**

670 vdekje duke pasur një raport pozitiv të rritjes së popullatës për gjithë bashkinë.

Bashkia drejtohet në mandatin e gjashtë të tij nga Kryetari **Z. Gëzim Topçiu**, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore morën pjesë rreth 29,74% e zgjedhësve.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)		FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
		1,175,592	2,012,751	1,073,917	1,264,040	84%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga tarifa vendore	39,042	34,137	36,774	167,460	21.96%
	Të ardhura nga taksat lokale	55,549	43,443	31,585	93,040	33.95%
	Të ardhura nga taksat e ndara	25,506	11,831	27,607	26,700	103.40%
	Të ardhurat e tjera	10,729	9,754	13,621	12,800	106.41%
	Huamarrje					
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	489,005	381,049	462,815	477,488	96.93%
	Transferta e pakushtëzuar	278,457	286,580	299,169	293,303	102.00%
	Trasferta specifike	145,335	148,950	160,656	151,732	105.88%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi me destinacion	131,969	97,007	41,690	41,517	100.42%
	Trashëgimi pa destinacion					

■ Të ardhurat e veta
■ Të ardhurat nga Qeveria Qëndrore
■ Trashëgimi nga viti i shkuar





Figura 1. Peshat e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet në gati 80% nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit luhaten në kufijtë 10-15% të të gjitha të ardhurave të bashkisë. Edhe pse një vit jashtëzakonisht i vështirë 2020 shënoi një rritje të kontributit të burimeve të veta të financimit kundrejt vitit 2019 duke reflektuar kështu ndryshimin që vjen prej rritjes së kontribut të QQ kryesisht për projekte investimesh në këtë bashki. Edhe pse një i vështirë ekonomik prej situatës pandemike të ardhurat e bashkisë njohën rritje, kështu:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 6% kundrejt vitit 2019 ku ato nga taksat, dhe tarifatat lokale u rritën me 11%;
- ✿ Totali i burimeve të financimit të bashkisë u realizua në masën 84% kundrejt planit për vitin 2020.

Shpenzimet buxhetore




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 shënuan rritje kundrejt vitit 2019 me rreth 4%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2020 ishte rreth 82%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Kujdesi social për familjet dhe fëmijët*
- ✿ *Planifikimi Menaxhimi Administrimi*
- ✿ *Shërbime publike vendore*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Rrjeti rrugor*
- ✿ *Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit*
- ✿ *Furnizimi me ujë*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
	344,160	137,009	109,879	115,739	95%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 110 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2019 investimet janë ulur me rreth 20% kjo shpjegon uljen e kontributit të tyre në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 95%.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 karakterizohen nga:

- ✿ Pësha e tyre në gjithë buxhetin e bashkisë në fund të vitit 2020 zë rreth rreth 11% nga 14% që ishin në vitin 2019
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, ujësjellësa në njësitë administrative rurale; rikonstrukcioni stadiumit në Maliq; rikonstrukcione të pallateve në Lagjen 1 Maliq; përmirësimi i hapësirave të gjelbërta, përmirësimi i terreneve sportive në disa shkolla etj.

Treguesit Financiar

Treguesit Financiarë të shprehur në %	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	TRENDI I PERFORMANCËS
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	0.0%	0.0%	0.0%	0.00%	→
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta					○
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave					○
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	30.9%	14.4%	22.3%	17.39%	↓
Norma e shpenzimeve korente ndaj totalit të shpenzimeve	69.1%	85.6%	77.7%	82.61%	↓
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	31.4%	36.3%	43.9%	37.40%	↑
Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve					○
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	11.1%	9.8%	10.2%	23.73%	↑
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave	10.2%	8.8%	8.9%	22.72%	↑
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	94.6%	99.5%	94.4%	100.00%	→

Dy fjalë mbi treguesit kyç financiarë

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.

Përgjatë vitit 2020 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- ✱ Rritja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi
- ✱ Rritja e peshës që zënë të ardhurat e veta të bashkisë si edhe ato nga taksat dhe tarifatat vendore në totalin e burimeve të financimit
- ✱ Ulja e peshës së investimeve dhe rënia e peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✱ Ulja e peshës së të ardhurave të veta të bashkisë në tërësinë e burimeve të financimit të buxhetit të saj
- ✱ Ekzekutimi i buxhetit mbetet në të njëjtat nivele duke u treguar të kujdesshëm për të mos krijuar borxhe të reja kundrejt të tretëve.

Administrimi i bashkisë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	152,266	15%	87%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		-5.00	13.00	-4.00
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	5.37	34.01	19.05	6.54
Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajtuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	0.82	0.81	1.82	2.00

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ditë trajnimi në total	36	65	20	200
Numri total i personave të trajnuar	44	80	11	100

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë	99,597	97,749	97,439	108,543
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	10	5	18	1
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	8	50	28	10
Numri total i punonjësve të bashkisë	149	147	147	153

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Administrimi i bashkisë	43,048	50,248	4,404	5,051	87%

Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
B/F permiresimi i banesave			2,321	2,321	100%
Blerje aparat fotografik+video projektor		149			
Blerje fazane		191			
Blerje fotokopje		323			
Blerje kafshë per Pyllin e Fazanëve				400	0%
Blerje kasaforta				150	0%
Blerje kompjutera		702			
Blerje mjete transporti	2,980				
Blerje ndricuesa	3,703				
Blerje ndricuesa viti 2018		1,732			
Blerje ndricuesa viti 2019		3,900			
Blerje rafte arkivi		215			
Blerje stende informacioni				120	0%
Blerje tabele		100			
Blerje te tjera pajisje zyre		322			
Furnizim vendosje motorr mjeti AA797 IR			99	99	100%
Investime aparati					
Makina Kartmonedhash				550	0%

Mbikqyrje + Kolaudim			1,054	3,000	35%
Mbikqyrje + kolaudime	3,031				
Mbikqyrje +kolaudime		3,071			
Ndërtim rikonstruksion godina e Bashkisë Maliq faza I	9,836				
Ndërtim Ujesjellesi Zvezde			231	250	92%
Oponence proj ujesj Mancurisht		260			
Pajisje ngrohje Kondicioner			120	200	60%
Pallati I kulturës 2018		224			
Pompë Lavazho				100	0%
Portbarazhi kolektori I Sovjanit		2,266			
Projekt Stadiumi Maliq		456			
Rikonstruksion godina e bashkise F II		37,981			
Rikonstruksion objekte administrative		600			
Rikonstruksion pallati blloku 1 Maliq			434	434	100%
Studim mjedisor Rruga Maliq-Drithas		39			

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 87% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 15% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të përmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✧ Është përmirësuar monitorimi i proceseve të brendshme në punë kjo ka cuar në gjetjen e më shumë parregullsive e për rrjedhojë më shumë masa disiplinore dhënë punonjës të bashkisë;
- ✧ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratë. Është dyfishuar numri mesatar i ditëve të trajnimit për një person të trajnuar;
- ✧ Është ulur numri i personave që kanë lëvizur nga puna duke rritur qëndrueshmërinë e administratës.

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	445,193	43%	100%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Familjeve në nevojë të mbështetura (Ndryshimi vjetor në numër)	2.00	-2.00	18.00	0.00
Fëmijë pa përkujdes prindëror që kanë përfituar nga shërbimet e shërbimit social (Ndryshimi vjetor në numër)	12.00	-12.00	0.00	8.00
Fëmijë që kanë përfituar nga shërbimi në qendra sociale dhe rezidenciale (Ndryshimi vjetor në numër)	0.00	0.00	0.00	1.00
Gra viktime të dhunës në familjet të trajtuara me mbështetje (Ndryshimi vjetor në numër)	0.00	0.00	14.00	0.00

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia	1,628	1,628	1,642	1,642
Fëmijë të shërbyer në kopshte dhe çerdhe nga të cilat:	755	790		840
Fëmijë në çerdhe	75	80		90
Fëmijë në kopshte	680	710		750
Fëmijë të shërbyer nga bashkia:	8	8	21	18
Fëmijë të shërbyer në Qendra ditore	0	8	18	18
Fëmijë të shërbyer në Qendra rezidenciale	8	0	3	0
Viktima të dhunës në familje dhe / ose viktima të trafikuar të mbështetura nga bashkia	15	12		8
Kopshte dhe çerdheve funksionale nga të cilat:	34	34	34	34
Kopshte funksionale	32	32	32	32
Çerdhe funksionale	2	2	2	2

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për familjet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 100% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 43% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si:

- ✿ Familje dhe fëmijë në nevojë
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Fëmijë në qendra ditore
- ✿ Gra dhe fëmijë viktima të dhunës

Edhe pse një vit pandemik bashkia i ka ofruar shërbim në numri më të madhë fëmijësh në çerdhe dhe kopshte.

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	93,341	9%	88%

Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	78	80	75	80
↓	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	45	45	47	47
↓	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	46	46	47	47
↑	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)	1,394	1,192	1,393	1,877

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	67	67	67	67
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	245	245	255	255
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	86	86	80	80

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	1,404	1,404	1,217	1,215
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	371	371	344	344
Mësues në sistemin parashkollor	87	87	81	81
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	120	130	140	140
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	3,938	3,938	3,780	3,780
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë	122,336	79,885	93,341	105,968

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 88% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet në një fond prej mbi 11 milionë lekë janë realizuar pothuajse tërësisht sipas planit. Këto investime synojnë përmirësimin e terreneve sportive të institucioneve shkollore si edhe rritjen kushteve të mësimë dhënies dhe mësim nxënies. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 9% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✧ Është ulur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✧ Është rritur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve;
- ✧ Është ulur kostoja e një institucioni arsimor duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim;
- ✧ Investimet e realizuara përgjatë viteve synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 26% të planit.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	47,185	2,470	11,430	11,650	98%
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Investime arsim 9- vjecar					
Ndërtim Shkolla Rembec	21,602				
Rehabilitim i shkolles 9 vjecare Podgorie dhe rritëzimi i terreneve sportive te shkolles N.J.A.Vreshtas	13,885				
Rikonstruksion objekte shkollore	5,037				
Rikonstruksion objekte shkollore F II 2018		1,055			
Rikonstruksion objekte shkollore FII 2018		1,415			
Rikonstruksion tualete e catie shkolla Podgorie ,tualete shkolla Zvirine ,catia e shkolles Gore	6,043				
Rikonstruksioni Palestres shkolles 9 vjecare N.Tereza Lezhe	0	0			

Riparim çatie shkolla fillore Blinisht dhe riparim kopshti fsh.Ungrej dhe Kotërr	0	0			
Rrethim i Shkollës së Mesme Kalivaç	0	0			

Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	57,480	6%	41%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi

Objektivat dhe Treguesit e Performancës

Fakti 2018

Fakti 2019

Fakti 2020

Plan 2020

→	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në %)		-0.5	0.0	-0.2
→	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në %)		-0.8	0.0	0.1
→	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		10.0	0.0	0.0
→	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		10.0	0.0	0.0
→	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në %)		0.3	0.0	-0.3
→	Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		0.0	0.0	0.0
→	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë rurale	0.0	0.0	0.0	0.0
→	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë urbane	0.0	0.0	0.0	0.0
↓	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	0.0	35.4	100.3	0.0

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 41% të planit 2020 në një vlerë prej mbi 57.5 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 82% të tyre. Investimet janë dyfishuar në fund të vitit 2020 krahasuar me ato të vitit 2019, duke sjellë edhe përmirësim të komunikimit ndërlokal. Bashkia shpenzon rreth 6% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✿ Është ruajtur i njëjti ritëm në shtrimin me çakull apo asfaltim të rrugëve urbane apo rurale
- ✿ Janë rritur (pothuajse trefishuar) kosto mesatare e 1 km linear rrugë të shërbyer.

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	563	573	573	573
Rrugë rurale të mirëmbajtura	552	562	562	562
Rrugë urbane të mirëmbajtura	11	11	11	11
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me çakull) në vit	2	2	2	2
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	2	1	1	1
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	0	1	1	1

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	563	573	573	573
Rrjeti rrugor rural	552	562	562	562

Rrjeti rrugor urban	11	11	11	11
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)	2	0		0
Numri i aksidenteve të automjeteve	1	0		0
Numri i aksidenteve të këmbësorëve	1	0		0
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë:				
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rural	238,272	46,316	57,480	138,670
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit urban	146,490	6,198	51,480	132,670
	91,782	40,118	6,000	6,000

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Rrjeti rrugor rural	222,160	26,041	47,148	47,148	100%

Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Blerje eskavatore me zinxhire	41,749				
Blerje pajisje topografike	1,054				
Kontratë shtese sistemim asfaltim F II 2018		2,600			
Ndertim prita , fusha Maliqit F I 2018		9,638			
Ndertim prita , fusha Maliqit F II 2018		3,989			
Ndërtim ura Osoje		1,725			
Rehabilitim i rrugës hyrëse Pylli i Fazanëve	3,261				
Rehabilitim rruga Lapidari, Zvezde				3,000	
Rikonstruksion sistemim asfaltim I rruges Petrushe – Vreshtas	83,026				
Riveshje rruge me asfalt		2,531			
Rivitalizim i rrugës Pendavinj–Pojan–Zvezde	39,039				
Rivitalizim i rruges Sovjan – Luadishte përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore	29,930				
Rruge me cakëll Moglice, rikonstruksion rruge në Nj.A.Gore	4,229				
Sist. Asfaltim Rrugë në Njësitë Administrative				32,000	
Sistemim -Asfaltim rruge +sheshe Qyteti Maliq				15,000	
Sistemim asfaltim Maliq Nja FI 2018		10,859			
Sistemim asfaltim Maliq Nja FII 2018		5,930			
Sistemim asfaltim rruga Blloku nr 3	3,750				
Sistemim asfaltim rruga fshati Podgorie	2,692				
Sistemim asfaltim rruge në Njësitë Administrative			47,148		
Sistemim rreth rrotullim Maliq	935				
Sistemim rruga ndërtim trotuare Maliq	13,703				

Furnizimi me ujë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	28,323	3%	37%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
Orë ujë në ditë (Ndryshimi vjetor në orë)	13.0	2.0	0.0	2.0
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	62.4	65.4	67.0	105.4
Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korrente (në %):	1.4	0.0	0.0	1.0

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (orë ujë në ditë)	13	15	15	17
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	26,540	26,540	28,625	28,625

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) në Mijë Lekë	56,182			
Popullsia totale e bashkisë	41,757	41,757	41,757	41,757
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm në Mijë Lekë	1,440	2,938	1,828	1,828
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm në Mijë Lekë	29,507	33,626	28,323	50,000

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në masën 37% të planit 2020. Bashkia kontribuon me investime për të përmirësuar shërbimin kryesisht në zonat rurale pasi ky shërbim është i konsoliduar tashmë në pjesën urbane të bashkisë. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitetet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Investimet kapën vlerën mbi 28 milionë lekë, të cilat zënë rreth 3% të buxhetit të bashkisë. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është rritur mbulimi me shërbim i popullatës, priten përmirësime të mëtejshme për shkak të investimeve të përvitshme në ujësjellësat e fshatrave;
- ✿ Në pjesën urbane uji ofrohet në vazhdimësi për 24 orë, mesatarja e kohëzgjatjes së ujit për gjithë territorin e bashkisë është 15 orë, nivel ky i ruajtur përgjatë tre viteve të fundit.


INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Furnizimi me ujë	28,082	33,626	28,323	29,031	98%
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Furnizim vendosje matësa uji	2,824				
Furnizim vendosje matësa uji ne fushe te thate, kasete lidhje	4,125				
Investime ujësjellës + KUZ					
Ndert ujesjellesi Bregas,Strelce			20,482		

Ndert ujesjellesi, Mesmal			3,340		
Rehabilitim përroi fshati Zvezde	4,274				
Rrjeti i brendshem ujesjellesi Symiz			2,950	6,825	43%

Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	13,367	1%	88%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia mbështet menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor si një burim i rëndësishëm i ekonomisë vendore.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
	Nr. kontrollesh dhe inspektimesh kundrejt sipërfaqes totale të pyjeve dhe kullotave (inspektime për 1000 ha)	25	21	23	21
	Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullor (punonjës për 1000 ha pyje dhe kullota)	1	1	1	1
	Pemë të reja të shtuara në vit	138,395	510,000	120,000	122,000
	Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (mije Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)	0.43	0.37	0.42	0.43
	Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor (ndryshimi vjetor në ha)		6,756	-2,739	0
	Verifiko ka plan menaxhimi të vlefshëm	1	0	0	1

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plani 2020
Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të fondit	720	720	750	750
Numri i pemëve të reja të shtuara në vit	138,395	510,000	120,000	122,000
Plan menaxhimi i fondit pyjor dhe kullor	1	0		1

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plani 2020
Numri i punonjësve në shërbimin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullor	15	15	15	15
Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit në lekë	11,940	13,300	13,637	15,445
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor në ha	28,345	35,101	32,362	35,101

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për aministrimin e fondit pyjor dhe kullor në pronësi të saj. Ajo ofron konservimin, zgjerimin dhe shfrytësimin racional të rezervës pyjore, duke mbikqyrur dhe disiplinuar operacionet pyjore dhe dhënë licensa për prerje pemësh në masën 88% kundrejt planit 2020. Bashkia mbështet veprimtaritë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si edhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë. Bashkia shpenzon për këtë shërbim rreth 1% të të gjithë buxhetit të saj. Performanca e këtij shërbimi tregon:

- ✿ Rritjen e numrit të pemëve si pjesë e fondit pyjor;

- ✿ Rritur numri kontrolleve për sigurimin që përdorimi dhe mbrojtja e fondit pyjor bëhet sipas kuadrit ligjor;
- ✿ Siguruar që popullata ka dru për ngrohje sipas mundësive për shfrytëzim të fondit pyjor në pronësi të bashkisë
- ✿ Lehtësisht rritur kosto mesatare e një hektar fond pyjor të menaxhuar
- ✿ Ulur sipërfaqja e fondit pyjor